

Aladin Husić (2023), *Devširma u Bosni - O regrutaciji Bosanaca u janičare* (fq.164). Sarajevo: Orijentalni Institut

Muhamed Mufaku*

Duke e marrë parasysh se libri i parë mbi devshirmenë në Ballkan u botua në vitin 1898, në Beograd, (Jovan Tomić, Danak u krvi, Beograd), mund të themi se libri i ri për devshirmenë që u botua në Sarajevë, në vitin 2023, paraqet një ngjarje shkencore, pasi ai paraqet një imazh tjetër për këtë institucion të rëndësishëm të Perandorisë Osmane. Si i tillë, ai u prit me interes, dhe deri më tani u recensua në gjuhën serbe e në gjuhën arabe. Kuptohet, midis viteve 1898-2023 u botuan shumë studime në gjuhët evropiane dhe orientale për devshirmenë, por libri i A. Husić-it paraqet një kontribut serioz për devshirmenë në Ballkan, i cili ishte rezervuari kryesor për rekrutimin e djemve për këtë institucion.

Ky kontribut paraqet në një mënyrë, traditën shkencore të “Institutit Oriental” në Sarajevë, qoftë me botimet e tij apo me anë të revistës shkencore (POF) që e paraqitën në mënyrë më objektive këtë institucion të rëndësishëm të Perandorisë Osmane.

Ky libër i ri i A. Husić-it kurorëzon angazhimin e tij që filloi në vitin 2011 me studimin: “Mbi disa karakteristika të pranimit të Islamit në Bosnjë” (POF 60, Sarajevë, 2011) dhe u thellua me studimin “Mbi rekrutimin në Axhami Oglan në Bosnjë, në vitin 1565” (Anali GHB XXXVII, Sarajevë, 2016), duke vazhduar me hulumtime për librin që e kemi në dorë tani.

Në krahasim me librin e parë, që doli më 1898, tani kemi një libër që mbështetet në burime osmane të dorës së parë, të pabotuara dhe të botuara, si dhe në libra dhe studime në gjuhë të ndryshme që janë marrë me devshirmenë. Ndaj, mund të themi se tanimë e kemi një libër që meriton të përkthet në gjuhën angleze, që të prezantohet “Shkolla e

* Profesor i historisë.

Institutit Oriental”, si dhe në gjuhën shqipe, pasi aty përfshihen disa vise shqiptare.

Në hyrje (fq.7-12), autori nisët nga imazhi negativ për sundimin osman në Ballkan, që përfshinte çdo fushë të jetës përkundër asaj që sundimin osman kishte kontributin e vet në jetën ekonomike dhe kulturore. Mu në këtë kontekst, devshirmeja, si institucion, duket shumë keq sikurse institucionet tjera osmane. Mu për këtë, libri kishte për qëllim të tregonte gabimin e madh midis qëndrimit të historiografisë ballkanike dhe realitetit të devshirmes në Ballkan në përgjithësi, dhe në Bosnjë në veçanti. Në këtë kontekst, autori sqaron se historiografia ballkanike u mbështet në “qasje romantike” që paraqitet në tekstet shkollore me shprehjet si “rrëmbimi i djemve” dhe “haraç i gjakut”, kurse shprehja osmane (zgjedhja e djemve) tregon diçka tjetër.

Në kapitullin e parë me titull “Devshirme në literaturën historiografike” (fq. 13-44), autori thekson se devshirmeja prezantohet më shumë në gjuhët ballkanike si “haraç i gjakut”, kurse vetëm “Enciklopedia kroate” e përmend versionin osman të këtij institucioni (devshirme). Autori e sheh këtë si pasojë e asaj qasjeje të njëanshme që dominon në historiografinë ballkanike, e cila bazohet më shumë në udhëpërshkrime e rrëfime gojore e jo në burimet përkatëse.

Kapitulli i dytë i quajtur “Mbi devshirmenë nëpër perspektiva të ndryshme”, (fq. 54-65), përqendrohet në udhëpërshkrimet e autorëve evropianë që kaluan nëpër Ballkan, në rrugën e tyre për në Stamboll dhe rreth vlerës së këtyre udhëpërshkrimeve. Duke pranuar se këto kishin disa të dhëna të sakta, por shumica e të dhënave nuk ishin objektive ose ishin të njëanshme, sepse ato nuk përkojnë me ligjet dhe praktikat e njohura të devshirmesë. Si shembull, autori e përmend këtu librin e Petër Matkoviç-it, “Udhëtime nëpër Gadishullin Ballkanik në shekullin XV”, ku vet autori tregon se motivi i tij për këtë libër ishte “të përshkruhet sa më keq gjendja e të krishterëve në Turqi, me shpresë që sundimtarët e krishterë do të angazhohen për dëbimin e Turqisë prej vendeve të krishtera”.

Kuptohet, me vështrimin e këtyre udhëpërshkrimeve, që u bënë “referenca” për studiuesit, A. Husić nuk do ta paraqesë devshirmenë në mënyrë ideale, por në bazë të dokumenteve osmane trajton edhe “keqpërdorimet gjatë rekrutimit të djemve për devshirme”, që tregojnë shumë akuza kundër funksionarëve që merrnin rryshfet gjatë procesit

të zgjedhjes së djemve për devshirme. Sidomos gjatë shek. XVI-XVII, gjë që e shtyu Sulltan Muratin IV - (1623-1640) të nxjerrë disa vendime për të rregulluar sistemin, duke caktuar edhe përcjellje sekrete për punën e funksionarëve që merreshin me rekrutimin e djemve për devshirme.

Në kreun e tretë: “Periodizimi i rekrutimit” (fq. 66-73), autori përsëri kthehet në udhëpërshkrime që sillnin të dhëna të ndryshme për periodizim (çdo vit, çdo pesë vjet, çdo shtatë vite), duke theksuar se në “Ligjin për jeniçerët” nuk kishte domosdoshmëri aplikimi, por është praktikuar sipas nevojës. Po ashtu, në lidhje me të, ai vështron në mënyrë kritike disa burime osmane, sikurse “Përmbledhja e Feridun beut” ku përmendet se vetëm nga Bosnja janë përmbledhur një mijë djem gjatë viteve 1515-1616, kurse dokumentet osmane tregojnë se nga të gjitha vilajetet e Ballkanit, gjatë shek. XVI u morën vetëm 2060 djem. Nga ana tjetër, dokumentet osmane tregojnë se për çdo rekrutim nuk përfshiheshin të gjitha vendet ballkanike, kështu që, më 1610 u përfshinë vetëm dy kaza në Kosovë, Peja e Vushtrria.

Në kapitullin e katërt “Nga praktikimi i rekrutimit në Bosnjë” (fq.74-98) autori dëshmon pasaktësinë e të dhënave në udhëpërshkrime, që tregojnë që rekrutimi përfshinte çdo të pestin djalë, e ndonjëherë më shumë, kurse dokumentet osmane përcaktonin shumë kushte për zgjedhje të djemve. Në këtë kontekst, autori kritikon udhëpërshkrimet që rritën shumë numrin e djemve të rekrutuar, kurse regjistrat osmane tregojnë se gjatë rekrutimit të vitit 1494, u zgjodhën vetëm 38 djem prej Hercegovinës. Po ashtu, udhëpërshkrimet tregojnë se moshat e djemve të rekrutuar ishin 7-8 vjeç, kurse regjistrimet osmane tregojnë emrat dhe moshat e tyre, 12-15 vjeç.

Me përhapjen e Islamit në Bosnjë, tani myslimanët e rinj fituan të drejtën që të përfshihen në rekrutim, pasi panë se djemtë që u rekrutuan arritën pozitën më të lartë në Perandorinë Osmane. Kështu, në kohën e Sulejman Kanunit - (1520-1566), Bosnja u bë burim kryesor për devshirme, me 27% të numrit të përgjithshëm të të rekrutuarëve nga Ballkani. Nga ana tjetër del se rekrutimi nuk përfshinte vetëm fshatrat, siç thuhet në udhëpërshkrime, por edhe qytetet në Bosnjë, madje 27% prej të rekrutuarëve ishin prej qyteteve.

Në kapitullin e pestë: “Jomyslimanët në rekrutim” (fq. 99-106), autori sqaron se në fillim rekrutimi përfshinte vetëm të krishterët që

ishin shumicë. Mirëpo, me arritjen e djemve të Bosnjës në pozita më larta deri në sedrazëm, si Hersekli Ahmet Zade dhe Atik Ali Pasha, rekrutimi nuk ishte më “privilegj” vetëm për të krishterët, por u zgjerua edhe te myslimanët. Kështu deri në fillim të shek. XVII, djemtë myslimanë u bënë shumicë e të rekreluarve, kurse të krishterët nuk ishin më shumë se 20%, gjë që përkonte me gjendjen në Bosnjë, si vend me shumicë myslimane.

Në kreun e gjashtë dhe të fundit me titull “Mbi disa çështje tjera të rekrutimit në Bosnjë” (fq. 107-127), nxirret në pah përsëri numri i zmadhuar i rekrutëve në udhëpërshkrime. Kështu, nga një sanxhak i madh, sikurse ai i Shkodrës, del sipas dokumenteve osmane, nga fundi i shek. XV, se u rekrutuan vetëm 48 djem, përkatësisht nga 2 djem prej çdo fshati. Në mesin e tyre ishin dy vëllezër (Aliu - 15 vjeç dhe Mehmeti -16 vjeç) gjë që praktikohesh si përjashtim. Kështu, nga Bosnja përmenden dy vëllezër të njohur në Perandorinë Osmane: Husrev Pasha (1495-1544) që u bë vali i Halepit dhe Lala Mustafa Pasha (1500-1585) që u bë vali i Damaskut.

Në këtë kapitull bëhet fjalë edhe për fatin e djemve, të cilët pasi kishin arritur në kryeqytet të Perandorisë, verifikoheshin emrat e tyre dhe bëhej testimi fizik dhe intelektual të djemve në bazë të cilit ndaheshin në dy grupe: një elitë që shkon në Shkollën e Pallatit ku pas mbarimit të studimeve shkon në poste të ndryshme, kurse grupi tjetër përgatitej për shërbim ushtarak.

Në fund të këtij kapitulli, kemi një analizë interesante që ka të bëjë me përbërjen etnike të elitës që u dërgua në fillim të shek. XVI në Shkollën e Pallatit. Kështu, nga 52 djem, boshnjakët dhe shqiptarët përbënin 68%, maxharët 22%, kurse në mesin e tyre kemi vetëm nga një arab e çerkez.

Në bazë të këtyre të dhënave të reja, na del se kemi të bëjmë me një kontribut origjinal në studimet osmane, që paraqet një imazh tjetër për devshirmenë në krahasim me atë që e kemi në udhëpërshkrimet evropiane dhe në studimet që u mbështeten në ato udhëpërshkrime. Edhe pse libri në titull jep të kuptohet se ka të bëjë vetëm me Bosnjën, por në të vërtetë ai përfshin edhe disa vise shqiptare të Kosovës e të Shqipërisë, ndaj është mirë të përkthehet në gjuhën shqipe e në të ardhmen të kemi një libër të tillë që përfshin viset shqiptare.